

**GJYKATA THEMELORE NE FERIZAJ,** si gjykatë civile e shkallës së parë me gjyqtarin Enes Mehmeti dhe bashkëpunëtores profesionale Mirlinda Bytyqi Rexhepi, në çeshtjen juridike-kontestimore, sipas padisë së paditësit [REDACTED] nga Shtimja, i përfaqësuar nga av. [REDACTED] nga Ferizaj kunder te paditurëve [REDACTED], [REDACTED] dhe [REDACTED] me adresë të panjohur të cilët i përfaqëson përfaqësuesi i përkohshëm [REDACTED] për vërtetim pronësie në seancën e shqyrtimit kryesor mbajtur me date 07.06.2016, në prezencën e paditësit dhe përfaqësuesit te paditesit si dhe [REDACTED] si përfaqësuesi i përkohshëm i të paditurve merr ketë:

### A K T G J Y K I M

**APROVOHET** në tërësi si e bazuar, kërkesëpadia e paditesit [REDACTED], nga Shtime,

**VËRTETOHET**, se paditësi [REDACTED] është pronar i paluajtshmërinë-ngastrës kadastrale nr. 00093-2 në vendin e quajtur “torino”, në sipërfaqe prej 5180 meter katror dhe nk.nr. 00093-3 në vq.”Torino” në sip.1071 meter katror , të shënuar në CDPP-UL.72809093-0268 ZK- Shtime dhe ng.kad.00093-1 në vendin e quajtur “Torine” në sip.prej 8311 meter katror të shënuara në CDPP-UL.72809093-00267 ZK-Shtime , në bazë të mbajtjes me mirebesim me mbi 20 vite.

**DETYROHEN**, të paditurit [REDACTED] dhe [REDACTED] që paditësit [REDACTED] t'ia lejojnë regjistrimin e kësaj të drejte në regjistrat kadastrale, të paluajtshmërive, pranë Drejtorisë së Gjeodezise, Kadastrit dhe Pronësisë në Shtime, në të kundërtën ky aktgjykim, do t'i shërben paditësit si autorizim për regjistrimin e kësaj të drejte në zyrën e paluajtshmërie në komunën e Shtime.

**OBLIGOHÉT**, paditësi që të paguaj taksën gjyqësore për aktgjykim në shumë prej 50 €, si dhe shpenzimet e procedures për përfaqësuesin e përkohshem av. [REDACTED] sipas tarifave të OAK-së.

### A r s y e t i m i

Paditësi me padi dhe zgjerimin e padisë dhe në parashtrimet në seancat e mbajtura, përmes të autorizuarit të tij, ka dekluaruar se nga i padituri i pare ka blerë paluajtshmërinë dhe atë ngastrën kadastrale nr. 00093-02 në vendin e quajtur “torino”, në sipërfaqe prej 5180 meter katror dhe nk.nr. 00093-3 në vq.” Torino” në sip.1071 meter katror , të shënuar në CDPP-UL.72809093-0268 ZK- Shtime, ndërsa nga i padituri i dytë ka blerë ng.kad.00093-1 në vendin e quajtur “Torine” në sip.prej 8311 meter katror të shënuara në CDPP-UL.72809093-00267 ZK-Shtime dhe shton se meqense nga mendimi i ekspertit të gjeodezisë rezulton se ka pasur ndryshim të pronarëve të njërës prej parcellave kontestues edhe atë parcellës nr.93-1 ZK Shtime e cila mbi bazën e

procedures trashëgimore është bartur në emër të [REDACTED] i dhe [REDACTED] të dy trashëgimtar të të paditurve [REDACTED] dhe [REDACTED] edhe me qëllimin që kjo procedure kontestimore të drejtohet në drejtim të ndryshimeve që janë bërë në mbititullarët e pronës bëjmë zgjerimin e padisë edhe ndaj [REDACTED] dhe [REDACTED].

Të paditurit përmes përfaqësuesit të perkohshëm [REDACTED] në seancën e shqyrtimit kryesor ka dekluaruar se nuk e konteston kërkesëpadinë e paditësit, se nga provat që janë nxjerr në besueshmërinë e tyre nuk kam kurfar dyshimi, se janë të denja për tiu besuar dhe fakti se ka ndyshuar pronari juridik i parcelës numër 93/1 Yk Shtime nuk ndryshon gjendjen e fakteve dhe provave të qeshtjes.

Dëshmitari [REDACTED] deklaron se paditësin e ka vëlla dhe ka qenë prezent me rastin e lidhjes së marreveshjes së shitblerjes dhe pagesa e qmimit është bërë ne dy pjesë dhe atë një pjesë në dinarë dhe pjesa tjeter në në franga. Sipas marreveshjes totali i qmimit ka qene 63,000 franga zviceriane dhe ne momentin kur ia kane dhene [REDACTED] 500.000 dinarë të athershem ka qenë prezent dhe pronën në fjal e kanë punuar nga viti 1987 pa asnje pengese nga asnjë person.

Gjkata me ndihmen ne ekspertit te gjeodezise ka bere identifikimin e paracelave object kontesti, konstatimin e gjendjes faktike te tyure dje ngfa vednimi iekspertit te gjeodezise ka rezultuar ka se gjendja faktike e provave edhe identike me ate kadastrale.

Gjkata, pasi vërtetoi se janë plotësuar kushtet ligjore sipas nenit 28.4 të ILTHMPJ, dhe duke u mbeshtetur ne shkresat e lendës ka vleresuar se egzistojne prova të mjaftueshme nga të cilat rezulton themelësia e kërkesëpadisë dhe se faktet mbi të cilat bazohet themelësia e saj si dhe provat me të cilat provohen pretendimet faktike të paditësit nuk janë në kundërthënie në mes tyre, përkundrazi ato provojnë pohimet e palëve ndërgjygjëse si të qena, andaj gjykata i aprovoi pretendimet e paditesit per bazueshmerine e kerkesëpadise se tij.

Gjkata ka obliguar paditësin qe te paguaj taksen gjyquesore për aktgjykim sipas UA.nr.2008/2 të KGJK-së ndersa shpenzimet për përfaqësuesin e përkohshem ne baze të nenit 81.2 lidhur me nenin 453 të LPK-së

**GJYKATA THEMELORE NE FERIZAJ**  
C.nr.703/12 datë 07.06.2016



**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e llogaritur ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të të njejtit në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë përmes kësaj gjykate.

